



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060-8505 dt. 13. 02. 2020

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z. Labinot Halilaj, me dt: 20.02.2020 (e ejte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa


Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 24.01.2020.
2. Propozim Vendim për miratimin e Propozimit Profesional për Shpalljen e Lokalitetit të Boshtrës (Forsythia europaea) në Golesh si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankog) në pjesën e Komunës së Glllogocit.
3. Rregullore për Organizimin e Punës në institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit.
4. Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2019.
5. Propozim vendim për miratimin e Statutit të ri të QKMF-së Drenas.
6. Të ndryshme.

Drenas, 13. 02 .2020

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Labinot Halilaj



Republika e Kosovë
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

Nr. 12.060-85-07 dt. 13.02.2020



PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 24.01.2020, ora 10:00.
Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Kryesuesi i Komunës Labinot Halilaj, Gani Podrimqaku, Blerina Gashi, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, Drejtori për Buxhet dhe financa Shyqyri Bublaku, Drejtoresha e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit Flutra Avdiu dhe përfaqësuesi i OSBE-së.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Betimi i asambleistit të ri Përparim Bajraktari nga Partia e subjektit politik, Vizioni për Drenasin, pas dorëheqjes së asamblistit Endrit Gllarevea në Kuvendin Komunal Drenas.
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 27.12.2019.
3. Draft Propozim strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal 2020 -2024.
4. Propozim Vendim për shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Drenasit për periudhën 2020-2028.
5. Plani vjetor i Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2020
6. Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2019:
 - a. Komiteti për Arsime Kulturë Rini dhe Sport.
 - b. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
 - c. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizua.
7. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit janar -- dhjetor 2019.
8. Njoftim rreth përfundimit të kontratave të shfrytëzimit të pronave të paluajtshme në Komunën e Drenasit.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: hapi mbledhjen e KPF, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës, i njoftoi anëtarët e KPF-së se kemi edhe dy pika shtesë për rendin e ditës: 1. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit janar-dhjetor 2019, 2. Njoftim rreth përfundimit të kontratave të shfrytëzimit të pronave të paluajtshme në Komunën e Drenasit.

Fitore Morina- kam kërkuar nga zyra e kuvendit Komunal që të na i dërgojnë materialin në email private pasi që emaili zyrtarë nuk po na bënë, dhe nuk na kanë dërguar!

Florentina Elezi- ka mundur me na dërguar por nuk e di se ku është problemi përderisa ky është material publik dhe me është duk absurde.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj, unë kam kërkuar që materiali të dërgohet vetëm në email zyrtarë për shkak që mos të bëhet shprehje e keqe që me ia dergu në email private. Këtë çështje besoj se do ta rregullojmë pa kurrfarë problemi.

Florentina Elezi- keni të drejtë mirëpo pasi që po kemi probleme gjithë asambleistat më email atëherë duhet me gjetë një alternativë të dytë dhe alternativa e dytë është email private.

Burim Bujupi- unë mendoj se nuk është çështje e vogël, dhe mendoj që është çështje për më u ngrit sepse e kam shikuar në procesverbal shumicën e vendeve shkruan zëri nuk dëgjohet, ndoshta e kanë rregulluar edhe këtë çështje, nëse një asamblist i bien se paku dy tri herë për me kërkuar materialin se pari është kosto financiare, dhe duhet me u përgatit për me ardh në komitet për Politikë dhe Financa, qoftë edhe për kuvendin, e dyta nëse nuk kanë mundur me përgatit materialin, e kanë bërë kërkesën dhe kanë mundur me ia dergu në email private, nëse është dërguar më herët në email private pse mos me u dergu në email private edhe kësaj radhe.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj, problemi nuk ka qenë tek zyra e Kuvendit, por tek unë mirëpo do ta rregullojmë këtë çështje.

Pasi nuk ka diskutime tjera Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj hodhi në votim këtë rendin e ditës se bashku me dy pika shtesë, a pajtoheni që në rend ditë të shtohen edhe këto dy propozim vendime ?

Florentina Elezi- e raporti financiar pse kaq me vonesë? Pse nuk ka ardhur më kohë përderisa ky raport nuk mundemi me kalu aq lehtë.

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku-Raporti financiar është përfunduar para datës 20 mirëpo duhet pritur shënimet i përpunimit të dhënave të sistemit SMFK dhe për ata gjithmonë dërgohet nga fundi i muajit janar, në të njëjten kohë Drejtoria për Buxhet dhe Financa përveq hartimit të raportit financiar ka edhe raportin e faturave të pa paguara, ka pasqyrat financiare vjetore, është e sterngarkuar në këtë periudhë kohore andaj duhet me na mirëkuptuar se secili raport donë kohë për përmirësime andaj kisha kërkuar mirëkuptim nga ju.

Burim Bujupi, e falënderoj drejtorin për sqarimin. Të gjithë po kuptojmë këtë mirëpo çka mundemi ne sot me diskutuar kur ne nuk e kemi pas materialin dhe nuk e kemi shfletuar se çka mundemi me u ndërlidh sot dhe me diskutuar a ka diqka mangësi me u diskutu apo jo. Nga ana jonë nuk është korrekte për arsye se nuk kemi mundur me e shfletuar materialin kështu që ne vetëm duhet ta votojmë për kuvend dhe me diskutu në kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj- materiali iu është dërguar me kohë nëse nuk e kemi dërguar po atë ditë se paku ia kemi dërguar dy ditë me vonë dhe materialin e keni të gjithë në email.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- materialin duhet me ia përcjellë me kohë dhe arsyetimin duhet me na dhënë për të gjitha të dhënat.

Burim Bujupi- nuk është në pyetje raporti financiar a votohet apo jo, mirëpo vlerësohet, ne po kemi problem me IT dhe është hera e dytë që kur po i mbajmë mbledhjet për Politikë dhe Financa procesverbalet po vijnë të zbrazura, asnjë fjalim nuk është në procesverbal me arsyetimin se nuk dëgjohet, të paktën munden zyrtaret me i mbajt disa shënime, pikat kryesore me i cek disa gjëra që janë diskutuar jo me qenë krejt e zbrazët, kjo është ajo çka po kërkojmë ne.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, zyrtaret e Kuvendit Komunal janë me mbajt raporte, me shkru procesverbal, në procesverbal nuk shkruhet e gjitha ajo çka thuhet por pjesa kryesore e diskutimit.

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku, pasqyrat financiare hartohen zakonisht në muajin janar dmth deri me 31 janar është data e fundit kur dërgohen në ministri të financave, kontrollimi i shënimeve ndodh që ka ndryshime në përpunim të dhënave dhe pasqyrat financiare lejohen deri më 28 shkurt të behën ndryshime nëse ka nevojë, dhe niveli qëndror e lejon me u përmiresu ato dmth e kanë lënë datën e fundit 28 shkurt për ndryshime, nëse ka ndryshime. Në raport financiar paraqiten gjitha të dhënat çka kanë ndodh gjatë vitit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hodhi në votim rëndin e ditës së bashku me këto dy propozim vendime shtesë, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtarë:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati.

Abstenim nuk pati.

1. **Betimi i asambleistit të ri Përparim Bajraktari nga Partia e subjektit politik, Vizioni për Drenasin, pas dorëheqjes së asambleistit Endrit Gllarevea në Kuvendin Komunal Drenas.**

Pasi nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime të gjithë anëtarët e K.P.F-ca u pajtuan që edhe kjo pikë e rendit të ditës të kalon për kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 27.12.2019**

Burim Bujupi- unë kam ankesa sa i përket procesverbalit jo vetëm unë por mendoj se edhe anëtarët e tjerë të Komitetit për Politikë dhe Financa, duke filluar nga materiali që e kemi pranuar fizikisht sepse materiali në shumicën e vendeve nuk po shihet as shkrimi, nuk është i printuar siç duhet, dhe është kjo hera e dytë që po ankoheni që nuk po bënë IT dhe por të paktën keni mundur me cek në procesverbal më shkrim dy tri pika kryesore e fjalimit i cili është diskutuar këtu, psh tek fq. Nr 3. Tek Burim Bujupi e keni shkruar nuk dëgjohet zëri, por se paku ka mundur me u shkrua në procesverbal se çka është diskutuar, sepse ky procesverbal publikohet edhe në ueb faqe zyrtare të komunës dhe duhet me ditë të paktën çka është diskutuar. Kërkoj nga ju që herave të tjera të keni pak më shumë kujdes dhe t'i bëni më mirë procesverbalet, dhe kërkoj me i fut të gjitha diskutimet tona në procesverbal, dhe materiali me qenë i gatshëm për seancat e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës me vërejtjet që u dhanë, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar. Me vërejtje apo sugjerime.

Kundër nuk pati.

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Draft Propozimi strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal 2020 -2024.**

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, sqaroi se është bërë një lëshim administrativ dhe për atë arsye u dashtë me e rikthye prapë në Kuvend, debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës i keni përfunduar edhe herën e kaluar në Kuvend dhe për shkak të këtij lëshimi administrativ që ka ardh si Draft pa propozim vendim për këtë arsye u dashtë prapë më kthye në kuvend, për këtë arsye nuk e kemi dërguar as në MAPL, është i njëjti material nuk ka ndonjë ndryshim në përmbajtje vetëm ka mungu propozim vendimi në material.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, pas sqarimit që u dha hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Propozim Vendim për shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Drenasit për periudhën 2020-2028.**

Drejtoreshë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu, siç jeni në dijeni Komuna e Drenasit është duke e hartuar Planin zhvillimor Komunal në të cilën ka filluar puna në hartimin e planit zhvillimor komunal i cili ka kaluar nëpër 4 faza kryesore siç janë: profili i gjendjes ekzistuese, koncepti i zhvillimit hapësinor dhe prioritetet strategjike me plan të veprimt, ne tani jemi në finalizim të këtij plani zhvillimor i cili parasheh zhvillimin e komunës

për 8 vitet e ardhshme mirëpo për të vazhduar në procedurat e miratimit final të planit zhvillimor, me ligj dhe me udhëzim administrativ të ministrisë së mjedisit për pjesëmarrje të publikut për planifikimin e planit zhvillimor është e përcaktuar që plani zhvillimor duhet të shkoj për tu hapur në shqyrtim publik duhet të miratohet një propozim vendim i cili ka për qëllimin shqyrtimin publik të projekt planit zhvillimor komunal për periudhën 2020-2028, dhe në këtë rast pasi të miratohet në Kuvend ky propozim për planin e zhvillimor komunal do të hapet shqyrtimi publik në të cilin vijnë edhe përfaqësues të ministrisë dhe qytetaret dhe hapjen e bënë Kryetari i Komunës, dhe 30 ditë është në shqyrtim publik në të cilën qytetaret mund të dhanë vërejtje sugjerimet apo komentet dhe pastaj përpilohet një raport, dhe me atë raport shkohet në ministri dhe merret pëlqimi final i ministrisë, ngase hapja finale bëhet me pëlqimin e ministrisë, pëlqimin e ka dhënë ministria që ta hapim në shqyrtim pastaj shkohet në miratim final të planit zhvillimor që besoj që deri në muajin mars do të vij në Kuvend.

Burim Bujupi- a kame pas komision për hartimin planin zhvillimor komunal, dhe nëse do të këtë prej sa natave do të jetë dhe a keni me bashkëpunuar edhe me anëtar nga Kuvendi Komunal?

Drejtoreshë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu- në pjesën e hartimit e keni tek arsyetimi, dhe është procesi i hartimit të planit zhvillimor komunal ka filluar me vendim i cili ka kaluar në kuvend u miratua, është një grup punues është prej gjitha drejtorive, është ekipi komunal për planifikim këta e kanë zhvilluar planin zhvillimor dhe na kanë ofruar të dhëna Gizi gjerman se ky është bashkëfinancim, prej të gjitha drejtorive me i marrë të dhënat që ka shërbyer si platformë dhe e kanë finalizuar me të dhënat e tyre, është grupi punues dhe këta e kanë hartuar planin, vitin 2018 ka qenë, dmth ka marrë një vit kohë derisa u finalizua, dhe prej këtij plani tani shkojmë me harta zonale që është i njëjti ekip.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: 5. Plani vjetor i Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2020

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, pasi nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime, të gjithë anëtarët në mënyrë anonime u pajtuan që edhe kjo pikë të kalon në kuvend.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: 6. Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2019:

- d. Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.
- e. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- f. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizua.

Fitore Morina- përse bëhen këto raporte?

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, janë të obliguar ata me raportua para kuvendit.

Fitore Morina- puna e tyre çka kanë punuar a merret si rekomandim për qeverisje, a keni marrë diçka model me ndryshu apo ndonjë rekomandim?

Burim Bujupi- këto raporte janë të mira se i ndihmojnë si rekomandime edhe për asamblenë , Kuvendin, i kam lexuar dhe i kam shikuar se kishin pas takime, raporti i komitetit konsultativ për mbrojtje të ambientit shëndetësi dhe mirëqenie sociale i kishin pas 4 takime, uroj që të kenë takime më shumë por kërkesa jonë është që herëve tjera kur të vijin këto raporte të jenë më të gjera, dhe të na tregojnë saktësisht se çka kanë punuar, të jenë më produktiv dhe të na ndihmojnë edhe neve, pse jo edhe juve çka ka nevojë për të mirën e qeverisjes lokale.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, këto komitete janë zgjedh tani vonë në fund të vitin 2019, se nuk mundemi me prit edhe shumë, mirëpo sa i përket takimeve ata janë të obliguar vetëm 6 takime me i mbajt brenda vitit, duhet me punu dhe me i arsyetua ato 6 takime.

Burim Bujupi- kërkesa ime është që me iu ndihmu sa ma shumë edhe pak drejtoreshës për Kulturë Rini dhe Sport për arsye se kur e kemi bërë shpalljen e sportistit të vitit për vitin 2019, ceremonia solemne ka qenë shumë e zbehtë, ka qenë për keqardhje, kisha kërkuar që këta me iu ndihmu edhe Drejtoreshën për Kulturë Rini dhe Sport, me iu dhënë ide për organizimet tjera, sepse organizimi i vitit 2019 për shpallje të sportistit të vitit ka pas shumë mangësi me i përmirësua, sepse edhe ne si komunë me pas një ambient më të mirë, më të ngrohtë.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci, sa i përket organizimit nuk ka pas buxhet me shumë dhe janë detyruar me mbajt në hollë të shkollës së mesme dhe atë ka pas buxhet.

Burim Bujupi- organizimi që bëhet bëhet a bëhet me mjete të subvencioneve apo me mallra dhe shërbime që janë të ministria për Kulturë Rini dhe Sport apo Drejtoria?

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci, këto i bënë drejtoria me buxhet të vetin, nëse nuk ka buxhet të vetin e merr nga një drejtori tjetër. Për eventin e sportit për këtë arsye e ka edhe komitetin me i sugjerua me i dhënë rekomandime si me bërë ma mirë, duhet të gjithë më kontribu që me e bë sa ma mirë

Burim Bujupi- unë mendoj se në të ardhmen kishë qenë mirë kur formohet edhe komisioni për ndarjen e shpërblimeve për sportist të vitit me qenë komision me shumë i përbërë prej sportistëve, e në komunën tonë kemi shumë sportist dhe shumë klube sportive duke filluar nga futbollit, basket , volejboli kemi mundur me i marrë të paktën dy ose tre anëtar të komisionit me qenë sportistë dhe ata janë më shumë në rrjedhë dhe kanë njohuri rreth sportit dhe ka mundur me qenë përzgjedhja më e mirë e mundshme, mirëpo ata sportista mundën me iu ndihmu edhe rreth organizimit, mbesim me shpres që herave të tjera do të kemi një organizim ma të mirë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar.

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: 7 . Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit janar – dhjetor 2019.

Pasi nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime **Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar.

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: 8. Njoftim rreth përfundimit të kontratave të shfrytëzimit të pronave të paluajtshme në Komunën e Drenasit.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci- ju i keni para jush 5 kontrata që e përfundojnë afatin 10 vjeçar të shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale, unë e kam kërkuar opinionin e ministrisë, ligji tani është në fuqi që pronat që janë dhënë në shfrytëzim për 10 vjet ato i kthehen komunës dhe i shpallë prapë komuna, po zakonisht ato kompani ka investu ta zëmë kanë pas sukses atyre munden me iu hap rrugë por procedurat ligjore duhet me u ndjek dhe e keni edhe përgjigjen nga MAPL-ja.

Burim Bujupi- kishte qenë mirë me qenë edhe një raport rreth këtyre kontratave , se ata përfitues a ju kanë përmbajt kontratës që e kanë nënshkruar më komunën sepse këta me siguri prapë kanë aplikuar, dhe nëse i kanë përmbush kriteret pse mos me ia dhënë një përparësi , prapë të njëjtëve që kanë qenë përfitues të pronës komunale.

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci, ne e kemi bërë shpalljen për prona këto që i marrim aplikojnë dhe ata që i kanë ato prona dhe sigurisht që kanë investuar duhet me lënë një mundësi që ata me pas përparësi.

Edolina Plakiqi- po i shoh këtu dy kontrata të lidhura 2005 dhe e kanë pas në shfrytëzim për 10 vjet, për 10 vjet po i bien deri në vitin 2015, që 4 vjet dmth ato e kanë shfrytëzo pronën pa kontratë?

Kryetari i Komunës z.Ramiz Lladrovci, ata që iu ka dalë kontrata në vitin 2014-2015 ata i kanë vazhduar kontratat ata i kanë krye obligimet ndaj komunës, por ligjërisht nuk kanë qenë në rregull.

Pasi nuk pati diskutime tjera **Kryesuesi Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar:

Për votuan 7 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: Të ndryshme


Burim Bujupi – i njoftoi se si anëtar i komisionit për emërtim të rrugëve ne kemi filluar me punën kemi fillu me dal ne teren dhe me i shqyrtuar kërkesat që janë adresuar prej zyrës se kuvendit të cilat i kemi marrë ne, pyeti se a duhet me ia sjellë të gjitha fshatrave përnjëherë në kuvend apo duhet me i sjellë kërkesat një nga një siç vijnë me radhë ?


Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, ju kur t'i sjellin duhet me i sjellë të gjitha, dhe më një seancë i votojmë të gjitha, komisioni i përgatit për gjithë komunën.

Pasi nuk pati diskutime tjera vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11: 35 min.

Drenas 30.01.2020

Procesmbajtëses

Liridona Fejza-Ajazi

Kryesuesi i Kuvendit

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Zyra e Kryetarit



01-Nr 030- 8029 dt. 12.02.2020

Duke u bazuar në Vendimin Nr.7518/18 të datës 19.12.2018, të Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për hartimin e arsyeshmërisë profesionale për shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës, vendimin 01-Nr.070-71395 të datës 17.12.2019, të Kryetarit të Komunës së Glllogocit për fillimin e procedurave për hapjen e konsultimit publik për Propozimin profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës nga data 17.12.2019 deri me datë 16.01.2019, në mbështetje të nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 paragrafi 1 pika (h) të Statutit të Komunës së Glllogocit, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, të miratoj këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për Miratimin e Propozimit Profesional për Shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (Forsythia europaea) në Golesh si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankoc) në pjesën e Komunës së Glllogocit

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Drenasit të miratoj Propozimin Profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (Forsythia europaea) në Golesh si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankoc) në pjesën e Komunës së Glllogocit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është Propozimi Profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (Forsythia europaea) në Golesh, dhe Harta e Arealit të Boshtrës, zonë e mbrojtur në kategorinë e Monumentit të Natyrës, punuar nga grupi punues sipas Vendimit Nr.7518/18 të datës 19.12.2018, të Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për hartimin e arsyeshmërisë profesionale për shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës.

Neni 3

Me miratimin e këtij propozim vendimi për miratimin e Propozimit Profesional për Shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (Forsythia europaea) në Golesh, bëhet shpallja si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankoc) që përfshin një pjesë të Komunës së Glllogocit.

Neni 4

Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave për zbatimin e vendimit është në kompetencë të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligshmërisë nga ana e MAPL-së.



ARSYETIM

Për hartimin e arsyeshmërisë profesionale për shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (*Forsythia europaea*) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës, Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me vendimin Nr.7519.18 të datës 17.12.2019, ka formuar Grupin punues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në këtë përbërje:

Qenan Maxhuni, IKMN- kryesues

Valmira Gashi, DMMU- anëtar

Elez Krasniqi, Prof Asoc. Dr. Departamenti i Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"- anëtar

Adnan Bullatovci, Komuna Fushë Kosovë- anëtar

Bajram Sinani, Komuna Lipjan- anëtar

Haki Bekolli, Komuna Glllogoc- anëtar

Përparim Gashi, SIM- anëtar



Pas hartimit të propozimit profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtrës (*Forsythia europaea*) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës nga grupi punues i formuar sipas vendimit Nr.7519.18 të datës 17.12.2019, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, me Propozimin 08-Nr.03070788 dt. 13.12.2019, duke u bazuar në Vendimin e Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës të


MMPH-së me nr.7518/18 të datës 19.12.2018, për Hartimin e arsyeshmërisë profesionale për Shpalljen e lokalitetit të boshtres (Forysthia europiana) Golesh si monument i mbrojtur i natyrës të paraqitur të Kryetari i Komunës, është kërkuar të merret vendim për lejimin e hapjes së konsultimit publik për Propozimin Profesional për Shpalljen e lokalitetit të boshtres (Forysthia europiana) Golesh si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime në Sankoc, në pjesën e komunës së Glllogocit të punuar nga grupi punues sipas vendimit të lartëshënuar.

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të propozimit 08-Nr.030-70789 dt. 13.12.2019, paraqitur nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (GZ Nr.28/2008), nenin 72 të Statutit të Komunës së Glllogocit 01-Nr.110-6904 dt. 24.09.2008, ka marr Vendim me të cilin Lejohet fillimi i procedurave për hapjen e konsultimit publik për Propozimin profesional për shpalljen e lokalitetit Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh, pjesë e fshatit Sankoc, Komuna e Glllogocit- "Zonë e Mbrojtur në Kategorinë e Monumentit të Natyrës".

Në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Glllogocit 01-Nr.070-71395 të datës 17.12.2019, për lejimin e hapjes së konsultimit publik për Propozimin Profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankoc) në pjesën e Komunës së Glllogocit të punuar nga grupi punues, është publikuar Njoftimi për Shpallje Publike në të cilën janë ftuar dhe njoftuar qytetarët për të shprehur mendimet për Propozimin Profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythia Europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës duke ndihmuar në dhënien e mendimeve, sugjerimeve, komenteve e vërejtjeve për këtë propozim dokument në afat prej 30 ditësh nga dita e hapjes së konsultimit publik.



Harta e Arealit të Boshtrës



Legjenda

Kufi komunal

Areali i Boshtrës

RD	WIKICAPAJ	AREAJA	SH	D
0	Gnjatovc	18 891.342	Poi	3
1	Fushë Kosovë	55 974.071	Poi	9
2	Lipjan	16 248.88	Poi	13

Agjencia për Shërbime të Niveliut të Komunitetit (ASNNK)
 Të. 078 220 13 229
 e-mail: www.asnnk@ksh.gov.mk





Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Propozim profesional
për shpalljen e lokalitetit të *Boshtres (Forsythia europaea)* në
Golesh zonë e mbrojtur në kategorinë e Monumentit të Natyrës

Prishtine, 2019

Propozimi profesional për shpalljen e lokalitetit të *Boshtres (Forsythia europaea)* në Golesh si zonë e mbrojtur është hartuar nga Grupi Punues me Vendimin Nr. Prot. 7518/18 datë 19.12.2018.

Sipas këtij Vendimi anëtar të këtij Grupi punues kanë qenë:

Qenan Maxhuni, IKMN – kryesues

Valmira Gashi, DMMU - anëtare

Elez Krasniqi, Prof. Asoc. Dr. në Departamentin e Biologjisë në UP/ FSHMN - anëtar

Adnan Bullatovci, KK Fushë Kosovë – anëtar

Bajram Sinani, KK Lipjan – anëtar

Haki Berkolli, KK Drenas - anëtar

Përparim Gashi, SIM - anëtar

PËRMBAJTJA:

• HYRJE	4
• BAZA LIGJORE	5
• OBJEKTIVAT	7
• KARAKTERISTIKAT FIZIKO - GJEOGRAFIKE	8
○ Pozita gjeografike dhe madhësia e territorit	8
• BIODIVERSITETI	10
○ Flora dhe vegjetacioni	10
○ Fauna	14
• GJENDJA	16
• MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI ME ZONËN	19
• PERFUNDIME	20
• LITERATURA	21

HYRJE

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës si institucion qendron përgjegjës për hulumtimin dhe evidentimin e vlerave të natyrës gjatë vitit 2005 ka bërë njohjen dhe evidentimin e vlerave të natyrës në territorin e Komunsë së Fushë Kosovës me ç'rast në dhjetor të po këtij viti i ka propozuar kësaj të fundit vënin nën mbrojtje të vendbanimit të llojit endemik *Forsythia europaea* (*Boshtra*) që gjendet në kodrën e Goleshit.

Meqenëse më vonë është konstatuar se kjo zonë ndodhet në kufirin administrativ ndërmjet territorit të komunave Fushë Kosovë, Drenas dhe Lipjan atëherë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/ Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës me datë 19.12.2018 ka nxjerrë Vendimin Nr. Prot. 7518/18 për themelimin e Grupit Punues për hartimin e Propozimit profesional për shpalljen e lokalitetit të *Boshtres* (*Forsythia europaea*) në Golesh si zonë e mbrojtur e natyrës. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233) hartimi i arsyeshmërisë profesionale të vlerave të natyrës është përgjegjësi dhe detyrë e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ndërsa me qëllim që monumenti si tërësi të merr trajtimin e merituar kuvendet e këtyre tri komunave do duhej që njëkohësisht të nxjerrjen vendimet mbi shpalljen e territoreve të tyre veç e veç si monument natyre.

Të dhënat e prezantuara në këtë Propozim profesional janë mbledhur nga arkiva e Institutit për Mbrojtjen e Natyrës dhe komunave përkatëse por me theks të veçantë janë pjesë e vizitave dhe ekspeditave hulumtuese në terren të studiuesve nga Departamenti i Biologjise të Universitetit të Prishtinës të udhëhequra nga Prof. Asoc. Dr. Elez Krasniqi në bashkëpunim me ekspertë të fushave përkatëse.

BAZA LIGJORE

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233), nen 14 - *Monumenti i Natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike. Monumenti i natyrës mundet me qenë gjeologjik - paleontologjik, mineralogjik, hidrologjik, strukture gjeologjike, sediment, gjeomorfologjik - shpella, humnera, muret shkëmbore, hidrologjik - burime, ujë rrjedhë, ujëvarë, liqe, botanik - ekzemplarë të rrallë ose të rëndësishëm të botës bimore për një lokalitet, lokalitet i vogël botanik ose zoologjik i rëndësishëm për vlerat e tij shkencore. Në monumentin e natyrës dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij që është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk lejohen veprimtaritë të cilat rrezikojnë karakteristikat dhe vlerat e tij.*

Shpalljen e vlerës së mbrojtur të natyrës për lokalitetin e *Boshtres (Forsythia europaea)* në Golesh e bënë kuvendi i komunës në territorin e së cilës gjendet, pas marrjes paraprake të pëlqimit nga Ministria.

Propozimi i aktit për shpallje mbështetet në propozimin profesional të hartuar nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, me të cilin përcaktohen vlerat e zonës e cila propozohet të mbrohet, mënyra e administrimit me atë zonë si dhe propozimi i organit i cili e nxjerr aktin për shpallje për sigurimin e mjeteve për administrim me zonën e mbrojtur.

Për propozimin e shpalljes së zonës së mbrojtur informohet publiku. Procedurën e qasjes publike për shpalljen e monumenteve të natyrës e organizon dhe e udhëheqë kuvendi komunal në territorin e së cilës gjendet zona dhe zgjatë më së paku tridhjetë (30) ditë.

Propozuesi i aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur ka detyrim që të deklarohet për propozimet që kanë dalë nga qasja e publikut, kurse vërejtjet e parashtruara nga debati bëhen pjesë përbërëse e dokumentacionit në të cilin bazohet propozimi për shpallje.

Lajmërimi për qasjen publike shpallet në mjetet e informimit publik dhe në ueb faqen e Komunës dhe përmban shënimet, dokumentacionin hartografik dhe dokumentacion tjetër lidhur

me zonën e propozuar për vënie në mbrojtje, afatin kohor për shqyrtim, datën e përfundimit të pranimit të komenteve dhe referencat e organit i cili i pranon komentet.

Komunat në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Strategjinë, programin e mbrojtjes së natyrës dhe dokumentet e rregullimit hapësinor janë të detyruara që të:

- kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore për territorin e vet;
- shpallin zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente;
- sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura për të cilat janë kompetente;
- marrin pjesë në procedurën e shpalljes të zonave të mbrojtura të cilat i shpallë Qeveria ose Kuvendi;
- marrin pjesë në hartimin e planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente;
- kujdesen për promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe japin mbështetje dhe kujdesen për shoqatat, veprimtaritë e të cilave është mbrojtja e natyrës;
- përcjellin gjendjen e ruajtjes së natyrës dhe për atë Ministrisë dhe Institutit i paraqesin raport;
- mbajnë regjistrat për shënimet të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës;
- informojnë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e vetë dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e sajë;
- ofrojnë ndihmë profesionale dhe ndihmë tjetër organeve të pushtetit lokal në mbrojtjen e natyrës në territorin e vetë;
- kryejnë dhe punë të tjera të përcaktuara me këtë Ligj dhe aktet nen ligjore të nxjerra prej tij.

Në vitin 2017 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bazë të dhënave nga Libri i Kuq i florës vaskulare të Republikës së Kosovës dhe Listës së propozuar nga Insituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, ka miratuar Udhëzimin Administrativ Nr.12/2017 për shpalljen e llojeve të egra strikt të mbrojtura ku *Boshtra* është pjesë e kësaj liste në kategorinë e IUCN-së si lloj më pak i rrezikuar (LC).

OBJEKTIVAT

Qëllimet e synuara me vënie nën mbrojtje të kësaj zone janë:

- Mundësimi i punëve hulumtuese kërkimore-shkencore, arsimore, kulturore, edukative dhe punëve të tjera profesionale në pajtim me konceptet bashkëkohore në zhvillimin e kësaj zone me synim ruajtjen e natyrës,
- Mbrojtja e ekosistemit dhe diversitetit biologjik, menaxhimi i qëndrueshëm si dhe marrja e masave për revitalizimin e ekosistemeve të dëmtuara,
- Shfrytëzimi racional i vlerave natyrore përmes mbikëqyrjes dhe kontrollit të zonës për të ndaluar degradimin e mëtejshëm të saj,
- Ndërmarrja e veprimtarive të përshtatshme të ruajtjes dhe menaxhimit, me qëllim të rivendosjes së kushteve ekologjike në ekosistemet dhe habitatet e degraduara.
- Realizimi i qëllimeve të përgjithshme të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik etj.

KARAKTERISTIKAT FIZIKO - GJEOGRAFIKE

- Pozita gjeografike dhe madhësia e territorit

Areali i bimës së Boshtres në Kosove është evidentuar në trekëndëshin e takimit të tre komunave Fushë Kosove, Drenas dhe Lipjan. Ky areal është evidentuar në një sipërfaqe prej 87.96 ha.

Nga kjo sipërfaqe pjesa më e madhe shtrihet në komunën e Fushe Kosovës 51.92 ha, pastaj Glllogocit me 19.65 ha dhe atë të Lipjanit me 16.39 ha.

Në aspektin gjeomorfologjik kjo hapësirë cilësohet si terren kodrinor malor që për nga gjeneza e formimit ju takon maleve të vjetra, përkatësisht vargut të Goleshit.

Pjesa më e madhe e këtyre maleve janë të zhveshura nga vegjetacioni drunor, ndërkohë që areali i shtrirjes së boshtres shtrihet në lartësi nga 740 deri në 990m i shoqëruar edhe me bimë tjera drunore.

Në aspektin gjeologjik, substrati i Boshtres në Golesh shtrihet kryesisht në formacionin e shkëmbinjve ultrabazik, ndërkohë që shikuar në aspektin pedologjik kjo hapësirë është e përberë prej tokave rendzine dhe pseudogleje.




Fig. 1. Pamje e zonës që propozohet për mbrojtje



Fig. 2. Pamje e luginave në të cilat është prezente Boshtro




Fig. 3. Harta e zonës së propozuar për mbrojtje

BIODIVERSITETI

Biodiversiteti është një nocion shumë kompleks që nënkupton tërësinë e llojeve dhe ekosistemeve, ose shprehur ndryshe biodiversiteti paraqet llojllojshmërinë jetësore në tokë.

Zona e propozuar për Mbrojtje – Kodra e Goleshit ka pozitë të volitshme gjeografike, me veçori hidrogjeologjike, pedologjike, me kushte të mira klimatike që e bëjnë këtë zonë interesante si në pikëpamje floristike dhe vegjetative ashtu edhe në atë faunistike dhe pelzazhore.

Kjo llojllojshmëri është rezultat i ndërveprimit kompleks të faktorëve biotik dhe abiotik të cilët krijojnë kushte të favorshme për llojllojshmëri të bimëve dhe shtazëve brenda kësaj zone.

Flora dhe vegjetacioni

Bazuar në hulumtimet e viteve të fundit në terren, në përgjithësi Goleshi me rrethinë karakterizohet me florë dhe vegjetacion të pasur. Vetëm në pyll dhe në vende shkurre në Golesh me rrethinë janë konstatuar më tepër se 100 lloje bimore të florës vaskulare. (Krasniqi, E. etj. 2015). Poashtu në pjesën me kullosa dhe vende shkëmbore, nga flora vaskulare janë konstatuar më tepër se 200 lloje bimore. Në kuadër të Goleshit me rrethinë, deri më tani janë konstatuar llojet endemike të ballkanit si në vijim: *Centaurea albertii*, *Forsythia europaea*, *Galatella albanica*, *Halacsya sendtneri*, *Paramoltkia doerfleri*, *Polygala doerfleri* dhe *Potentilla visianii*. Ky fitodiversitet i pasur i florës vaskulare karakterizohet poashtu me lloje bimore të kategorizuara për nga kërcënueshmëria sipas IUCN dhe të radhitura në Librin e Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës. Lloje bimore të vlerësuara sipas kritereve të IUCN, prezente në Golesh me rrethinë janë llojet bimore *Narcissus poeticus*, *Centaurea albertii*, *Galatella albanica*, *Klasea radiata*, *Halacsya sendtneri*, *Paramoltkia doerfleri*, *Linum flavum*, *Forsythia europaea*, *Polygala doerfleri*, *Potentilla visianii*, *Haplophyllum bolsserianum* dhe *Daphne cneorum* (Millaku, F. etj 2013).

Edhe vegjetacioni i Goleshit me rrethinë është interesant. Ky vegjetacion karakterizohet me vegjetacion të pyjeve, shkurreve e vendeve barishtore. Në kuadër të vegjetacionit të Goleshit me rrethinë është konstatuar prezenca e këtyre asociacioneve bimore: Nga matjet fitocenologjike është vërtetuar prezenca e fitocenzave pyjore, shkurreve dhe të kullosave. Sipas principeve dhe metodave të shkollës Zurich-Montpellier (Braun-Blanquet 1964, Rexhepi, F. 1994), janë konstatuar fitocenoza nga rendet *Quercetalia pubescentis* dhe *Halacsyetalia sendtneri*. Këto fitocenoza janë: *Quercetum frainetto cerris scardicum*, *Quercetum pubescentis cerris*, *Polygalo-Forsythietum europaeae*, *Hyperico-Euphorbietum glabriflorae* dhe *Potentillo-Fumanetum bonapartei* (Krasniqi, E. etj. 2017).

***Forsythia europaea* Deg. et Bald.**

Forsythia europaea Deg. et Bald. (Boshtër e Evropës, Boshltër, Bosht, Boshtër, Boshtërojë, Boshtupëz, Broshtull, Bushtërizë, Fangelqere, Fygjen, Fyshtër, Fyzhnje, Hyshtër, Kashtrojë, Klladër, Puzhën, Pyshtër, Shtogël, Shtogër, Ulër, Yshtë) (Krasniqi, F. etj 2003).

I takon familjes Oleaceae (Ullinjore).

Përshkrimi i llojit

Është bimë drurore – shkurre (Fanerofite-P), e lartë deri 3 m. Degëzat dhe nyjet janë me palcë dhe kthina. Gjethet i ka të thjeshta dhe eliptike ose vezake, të shogëta. Gjethet e degëve i ka pa lule të dhëmbëzuara deri në ura, ato të degëve me lule buzëplota, 5-8 cm të gjata. Lulet i ka të verdha me kupë rreth 3 mm dhe me kurorë -15 mm të gjata. Kapsula është 1.2-1.5cm, riprodhohet me farë, lulëzon IV-V, frytënon VIII-IX.

Është bimë endemike dhe relikte terciere e Kosovës dhe Shqipërisë. Është zbuluar nga Degen dhe Baldac më 1897 nga materiali i mbledhur në Kosovë dhe Shqipëri. Në Kosovë është e përhapur në rrethinën e Pejës (Gubavc), në rrethinën e Gjakovës (Qafa e Prushit deri në Ponoshec), rrethina e Rahovecit (Koznik, Zatriq), rrethina e Prishtinës (Golesh)(Rexhepi, F. 2000, Millaku, F. etj. 2013, Krasniqi, E. etj. 2015).

Habitati

Ky lloj në Kosovë rritet në vende shkëmbore – serpentimore duke krijuar pyje të rralla ose shkurre. Zakonisht rritet në shoqërim me llojet: *Cornus mas*, *Quercus pubescens*, *Quercus cerris*, *Acer monspessulanum*, *Fraxinus ornus*, *Sanguisorba minor*, *Centaurea montana*, *Viola sylvestris*, *Popygala doerfleri*, *Filipendula hexapetala*, *Crataegus monogyna* etj. (Millaku, F. etj. 2013).



Fig. 4. *Forsythia europaea* (Golesh, foto: Elez Krasniqi 10.04.2010)

Përhapja e përgjithshme:

Sipas Deg. et Doerfler (1897), Rexhepi (2000), Josifović, M. et al. (1973), Blečić et Krasniqi (1971), ky lloj është i përhapur në serpentinet e Shqipërisë veriore (regjioni i Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi) dhe në këto lokalitete të Kosovës: Gubavc, Koznik, rajoni i Mirushës deri afër Rahovecit, Qafa e Prushit, Bokat e Morinës dhe Golesh (Millaku, F. etj. 2013).

Populacionet:

Populacionet e këtij lloji në Golesh dhe në rrethinën e Koznikut (Zatriq, Mirushë) janë në gjendje më të mirë në krahasim me populacionet e këtij lloji në Qafë Prush, Qafë të Morinës dhe Gubavc. Populacionet më të degraduara dhe më me pak individë maturë janë populacionet në Gubavc (Pejë) dhe Bokat e Morinës. Për momentin populacionet e këtij lloji janë stabile. (Millaku, F. etj. 2013).

Kategoria e kërcënueshmërisë në Kosovë sipas IUCN

LC – Më pak i rrezikuar (Millaku, F. etj. 2013).

Arsyetimi i vlerësimit:

Ky lloj është vlerësuar nga hartuesit e Librit të Kuq të florës vaskulare të Kosovës në vitin 2013 si LC (më pak i rrezikuar) pasi që lloji për momentin nuk është i kërcënuar në atë masë sa që lloji të futet në ndonjë kategori më të lartë (Millaku, F. etj. 2013)..

Statuti ndërkombëtar

Taksoni nuk është përfshirë në Listën e Kuqe të florës së Evropës (Bilz, M., et al 2011) dhe as të botës (Walter, K.S., Gillett, H.J. 1998). Në listën e kuqe të Shqipërisë (MMPAU 2007) ky lloj kategorizohet si (NE) – Jo i vlerësuar (Millaku, F. etj. 2013).

Shkaqet e rrezikimit

Sipas Millaku, F. etj. (2013) Janë disa shkaqe që mund të rrezikojnë gjendjen natyrore të këtij lloji e ndër to:

1. Humbja dhe degradimi i habitatit (i nxitur prej njeriut),
2. Minierat,
3. Prerja selektive e drunjëve,
4. Prerja për pastrim,
5. Zjarret.

Masat mbrojtëse:

Përmes institucioneve përgjegjëse, në këtë rast Institutit për Mbrojtjen e Natyrës por edhe ekspertë të fushës duhet të monitorohen populacionet e këtij lloji në Kosovë. Habitatet ku rritet ky lloj janë të pasura edhe me lloje tjera endemike dhe relikte që kanë rëndësi shkencore (Millaku, F. etj. 2013).

Fauna

Fauna e Kosovës në përgjithësi është pak e studiuar. Në kuadër të kësaj hynë edhe ajo e Kodrës së Goleshit e cila me biotopet e saj ofron kushte të mira për jetesën e llojeve të ndryshme shtazore.

Gjatë vizitave hulumtuese në terren si dhe nga të dhënat që gjenden në arkivin e IKMN-së janë konstatuar disa lloje të shtazëve, e që më të shpeshta kanë qenë:

- Breshka tokësore (*Testudo hermani*),
- Hardhuca e gjelbërt (*Lacerta viridis*),
- Iriqi (*Erinaceus concolor*),
- Dhelpira (*Vulpes vulpes*),
- Lepuri i fushës (*Lepus europaeus*) etj.

Nga llojet e shpendëve në këtë zonë me rrethinë veçohet kryesisht:

- Huta (*Buteo buteo*)
- Gardallina (*Carduelis carduelis*)
- Pëllumbi i shkëmbit (*Columba livia*)
- Korbi (*Corvus corax*)
- Korbi sqep bardhë (*Corvus frugilegus*)
- Gala (*Corvus monedula*)
- Sorra (*Corvus corone*)
- Skifteri kthetrazi (*Falco tinunculus*)
- Dervishi (*Galerida cristata*)
- Dallëndyshja (*Hirundo daurica*)
- Harabeli i shtëpisë (*Passer domesticus*)
- Mëllenja (*Turdus merula*) etj

GJENDJA

Në zonën e propozuar për mbrojtje në të tri anët e sajë ka ndërhyrje si në zonën e gjerë ashtu edhe në atë të propozuar për mbrojtje.

Komuna e Fushë Kosovës

Sa l përket pjesës së parcelave me areal të Boshtres e që zhvillohet dhe jeton ne lokalitetin e Harilaqit, ndërhyrjet e evidentuara janë përreth Kalasë së Harilaqit (parku eolik), objekte për banim dhe disa objekteve afariste shërbyese të cilat në atë zone sipas PZHK-së kanë si destinim industrinë. Mirëpo, ndërhyrjet nuk janë të mëdha dhe areall i kësaj bime është ende në gjendje të mirë dhe sipërfaqet e mbuluara me të janë ende të ruajtura.




Fig. 5. Pamje e Parkut eolik në pjesën e Fushë Kosovës

Komuna e Drenasit

Zona e propozuar për mbrojtje e monumentit të natyrës gjendet në pjesën lindore të Komunës së Drenasit në kufi me Komunën e Fushë Kosovës dhe Lipjanit. Konfiguracioni i zonës është kodrinor në lartësi Min= 775 m dhe Max= 985 m ku përfshinë një sipërfaqe prej 38,4 ha që i takojnë vetëm Komunës së Drenasit.

Hapësira përreth arealit të llojit bimor Boshtra, është kryesisht e pasur me lloje bimore barishtore. Në kontekst të gjerë në afërsi të kësaj zone është në proces të planifikimit të ndërtohet stadlumi kombëtar, parku i biznesit 2 si dhe të bëhet zonë ndërtimore ku do të ngriten mullinj të erës. Ndërhyrjet e evidentuara janë aktivitete minerare - gurëthyes, mirëpo janë jashtë zonës së propozuar për mbrojtje. Gurëthyesi në afërsi të zonës nuk është funksional, mirëpo zona nuk është revitalizuar pas përfundimit të aktivitetit ashtu siç është e paraparë me ligjet në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.





Foto 6, 7 dhe 8. Pamje nga gjendja në zonën që i takon Komunës së Drenasit pas aktivitetëve

Komuna e Lipjanit

Sa i përket pjesës që i takon Komunës së Lipjanit në këtë zonë nuk ka ndonjë aktivitet që është zhvilluar ose pritet të realizohet. Gjithashtu territori i paraparë të përfshihet në kuadër të zonës së propozuar për mbrojtje është në pronësi publike dhe me këtë rast është përfshirë pjesa më e madhe e lokalitetit të llojit endemik Boshtra.

Meqenëse në të tri komunat janë në hartim e sipër Hartat Zonale Komunale me këtë rast ky lokalitet edhe para nxjerrjes së vendimeve nga ana e komunave përkatëse do të përcaktohet paraprakisht si zonë e mbrojtur e natyrës për llojin e Boshtres (*Forsythia europaea*) dhe do të përcaktohen kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj zone.

MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI ME ZONËN

Punët profesionale në monitorimin dhe hulumtimin e vlerave natyrore në zonat e mbrojtura të natyrës i kryen Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) si organ kryesorë qendror për mbrojtjen e natyrës, ndërsa përcjelljen e gjendjes së veçorive të rëndësishme dhe karakteristike e bëjnë komunat në bashkëpunim me IKMNn dhe personat tjerë juridik të autorizuar.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L- 233, do të përcjellë punën dhe zbatimin e masave të mbrojtjes së zonës duke dhënë mendime profesionale në planet e zhvillimit dhe në të gjitha vendimet të cilat janë të lidhura me këtë objekt të mbrojtur të natyrës.

Meqenëse komunat përkatëse do të nxjerrin vendimet për mbrojtjen e kësaj zone atëherë ato edhe do të jenë përgjegjëse në aspektet e menaxhimit dhe administrimit me këtë zonë.

Propozimi i aktit për shpallje – Vendimi, mbështetet në këtë propozim profesional në të cilën janë përcaktuar vlerat e zonës si dhe propozohet organi i cili nxjerr aktin për shpallje për sigurimin e mjeteve për administrim me zonën e mbrojtur.

PËRFUNDIM

Duke u mbështetur në vlerat e veçanta natyrore kjo zonë me kufijtë e përcaktuar dhe me sipërfaqe të përgjithshme prej **87.96 ha** (51.92 ha në K. e Fushë Kosovës, 19.65 ha në K. e Gllogocit dhe 16.39 ha në K. e Lipjanit) propozohet të vihet nën mbrojtje ligjore në kategorinë e Monumentit Natyror dhe të nxirren vendime përkatëse për mbrojtën e pjesëve të veta territoriale nga ana e tri Komunave përkatëse.

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet me të cilat lejohen dhe ndalohen aktivitete dhe veprimtari të caktuara, për zbatimin e të cilave kujdesen Komunitatet përkatëse.

Ndër masat që duhet të ndërmerren janë:

- mos ndërtimi i objekteve të pa planifikuara,
- shënjimi i kufijve të zonës së mbrojtur,
- vazhdimi i hulumtimeve të mëtejme të vlerave natyrore,
- mbrojtja adekuate e llojeve të rrezikuara,
- ndalimi i hedhjes së mbeturinave etj.

Masat tjera duhet të përcakton në vendimin për vënien nën mbrojtje të kësaj zone nga ana e të dy komunave përkatëse.

LITERATURA

- "Kopja e Planit dhe Certifikata e Pronësisë". Komuna e Drenasit - Zyra Kadastrale Komunale 2019.
- "Kopja e Planit dhe Certifikata e Pronësisë". Komuna e Fushë Kosovës - Zyra Kadastrale Komunale 2019.
- "Kopja e Planit dhe Certifikata e Pronësisë". Komuna e Lipjanit - Zyra Kadastrale Komunale 2019.
- Arkiva e IKMN-së
- Blečić, V., Krasniqi, F. (1972): Zajednica endemnog siblijaka forzicije i Krstusca (*Polygalo-Forsythetum europaeae* Blečić i Krasniqi) u jugozapadnoj Srbiji. Glas. Republ. Zavoda Zast. Prirode-prilodnjackog Muzeja Titograd. 4 (1971): 35-40. Titograd.
- Degen, Á.v. & Dörfler, I. 1897. Beitrag zur Flora Albanens und Macedoniens. Ergebnisse einer von I. Dörfler im Jahre 1893 unternommenen Reise. Denkschr. Kaiserl. Akad. Wiss. Wien, Math.-Naturwiss. Kl. 64: 701–748.
- Dakov, M. et al. (1984): Cervená knjiha na NR Bulgaria. BAN. Sofia
- Dhora, Dh. (2008): Fjalor i emrave të kafshëve të Shqipërisë, Botimet "Camaj-Pipa", 288 fq. Shkodër, SHQIPËRI
- Josifovic, M. et al. (1973): Flora SR Srbije V. SANU-Odeljenje Prirodno-Matematichkih Nauka. Beograd.
- Konventa mbi Diversitetin Biologjik (CBD), Rio de Janeiro 1992
- Krasniqi, E., Millaku, F., Gjoshi, G., Berisha, N., Rexhepi, F. (2015): SGEM 2015, Section Forest Ecosystems. 469-476. Albena.